L I G J
Nr. 8971, datë 14.11.2002

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8113, DATË 28.3.1996 "PËR DEKORATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8765, DATË 2.4.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr. 8113, datë 28.3.1996 "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001, bëhen shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:
"12. Medalja e Mirënjohjes".

Neni 2

Pas nenit 14/1 shtohet neni 14/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/2
Medalja e Mirënjohjes

Kjo medalje u jepet qytetarëve shqiptarë ose të huaj, në raste festash zyrtare dhe ngjarjesh historike. Medalja të jetë e artë.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3566, datë 19.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu